



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 7 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr. 670-24576 të datës 22.06.2020 për caktimin e numrit të bursave dhe shumës financiare për një bursë për studentë për vitin akademik-shkollor 2020/2021 , Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR ANULIMIN E KONKURSIT NR. 04-670-25540 DATË 25.06.2020 PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT.

I. ANULOHET, Konkursi Nr. 04-670-25540 DATË 25.06.2020, për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit për shkak të ndryshimeve në dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020.

II. Pas hyrjes në fuqi të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020 do të shpallet Konkursi i ri për ndarjen e bursave për student.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim.

1Nr. 111-47518
Lipjan, më 30.09.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

